



INFORMACIONE

Mars - Prill 2007

KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

Rruga: "Muhamet Gjollësia", Sheshi "M.Q. Atatürk", Tiranë

Tel. +355 235249/240602 Fax. +355 240565

E-mail: secretariat@nocalbania.org.al - www.nocalbania.org.al

TAKIM NË MINISTRINË E BRENDËSHME

Kampionati Ballkanik i Judos për policitë e shtetit

5 Mars 2007 - Në mjediset e reja të Drejtorisë së Policisë së Shtetit u zhvillua mbledhja e përbashkët e Grupit të Punës për organizimin e Kampionatit Ballkanik të Xhudos ndërmjet policive të Shtetit, që do të zhvillohet në Tiranë në datat 28-31 Maj 2007. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, dhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH promovuan nismën për të bashkëpunuar në organizimin e këtij aktiviteti sportiv. Në mbledhje mermin pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar dhe Federatës Shqiptare të Xhudos.



Mbledhje e Konisionit Teknik të KOKSH

Komisioni Teknik i KOKSH zhvilloi më datë 6 Mars mbledhjen e radhës ku kanë diskutuar lidhur me: • Konkluzionet e takimit për Bursat Olimpike "Pekin 2008"; • Përcaktimi i disiplinave sportive për Festivalin Olimpik Rinor Europian "Beograd 2007", që zhvillohet në datat 22-27 Korrik 2007 • Kandidaturat për Bursat e talenteve të Reja.

Në datën 16 Mars, Komisioni u mbledh sërish për shqyrtimin dhe përcaktimin e kandidatëve për projektet e lartë përmendura.

Në përfundim të mbledhjes, Kryetari i Komisionit Teknik dha një konferencë për shtyp.



" C I T I U S A L T I U S F O R T I U S "

Kursi Teknik i Kualifikimit të Trainerëve të Volejbollit - Niveli II



14-27 Mars 2007 Partnerë në projekt: Solidariteti Olimpik, KOKSH, FIVB dhe FSHV

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar përvijon me projektin e tij afat gjatë të kualifikimit të trajnerëve në rang kombëtar por edhe më gjerë. Kursi Teknik për Trajnerët e Volejbollit që ka si qëllim kualifikimin e trajnerëve sipas rregullave dhe metodave bashkëkohore të Federatës Ndërkombëtare të FIVB, ishte projekti i radhës i cili vjen falë financimit të Solidaritetit Olimpik dhe mbështetjes nga Federata Ndërkombëtare e Volejbollit. Në këtë kuadër KOKSH në bashkëpunim me FSHV, organizuan në datat 14-27 Mars 2007 nivelin e dytë të kualifikimit për licencimin e trainerëve sipas FIVB. Kursi u drejtua nga ekspertët e njohur të FIVB:

z. Jivko Jetchev dhe z. Zdenek Valasek.

Programi i kursit megjithëse i larmishëm dhe tepër intensiv i dizenuar në dy seanca – paradite teori dhe mbasdite praktikë, pati angazhimin e plotë nga pjesëmarrësit. Trajnerët pjesëmarrës shumica të rinj dhe nga qytete të ndryshme të Shqipërisë, disa prej tyre trajnerë të kategorisë së parë dhe sportistë, vlerësuan maksimalisht këtë kurs, pasi Shqipëria është i vetmi vend në Europë që përfiton nga ky kurs i nivelit ndërkombëtar.

Për të përshëndetur dhe vlerësuar Kursin, në ceremoninë e hapjes dhe atë mbylljes morrën pjesë Presidentët Hysen Domi KOKSH, Gjergj Liqejza FSHV; Sekretarët e Përgjithshëm Stavri Bello KOKSH, Leonard Tase FSHV, Koço Mikerezi Kryetar i Komisionit të Kualifikimit të KOKSH, Viron Bezhani Anëtar i Komitetit Ekzekutiv të KOKSH.

Për KOKSH, objektivi kryesor është që këto kurse do të ndihmojnë në ngritjen e një sistemi të qëndrueshëm për kualifikimin e trajnerëve pranë federatës përkatëse.

ICMG — Seminar për Administratorët e Rinj të Sportit – Paris

19-23 Mars 2007 - Komiteti Ndërkombëtar i Lojërave Mesdhetare për ti dhënë një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes dhe angazhimit të të rinjve në drejtim të organizatave sportive, ka organizuar në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Francez në Paris në datat 19-23 Mars 2007 "Seminar për Administratorët e Rinj të Sportit" ku morrën pjesë vendet e pellgut të Mesdheut ndërsa KOKSH u përfaqësua me znj. Elda Gjoka. Një Seminar të tillë por me një tematikë më të reduktuar KOKSH, ka organizuar në muajin Dhjetor 2006 në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Tiranë dhe Komitetin Olimpik Francez ku morrën pjesë të rinj, studentë dhe vullnetarë të Lëvizjes Olimpike Shqiptare. Është për tu theksuar se Lëvizja Olimpike po vlerëson gjithnjë e më shumë rolin dhe angazhimin e të rinjve në drejtim të organizatave sportive.

Kursi Kombëtar i Mjeksisë Sportive

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar organizoi në datat 28-30 Mars 2007 "Seminarin Kombëtar të Mjeksisë sportive". Në të morrën pjesë mjekë sportivë të Klubeve Shumësportëshe, Klubeve të Futbollit dhe punonjës shkencorë pranë Qendrës Kërkimore Shkencore. Gjatë seminarit u trajtuan tema të rëndësishme në fushën e Mjeksisë sportive, ku më kryesoret ishin temat:

1. Shkencat Mjekësore dhe Sporti
2. Përfitimi i ekspertizës Mjekësore në Sport
3. Ushqyerja tek sportisti
4. Biomekanika e sportit
5. Psikologjia sportive
6. Rritja, Pjekuria dhe Dëmtimet në aktivitetet sportive

Në Seminar u paraqitën arritjet dhe studimet më të fundit të shkencës në këtë fushë si dhe shëmbuj konkretë nga praktika botërore e lidhur me shëmbuj në vendin tonë. Seminari ishte një diskutim i hapur mes mjekëve mbi problemet që hasen në sportin shqiptar dhe u shkëmbyen dhe eksperiencat e tyre në këtë drejtim.

Mjekët i bënë apel mungesës së bashkëpunimit të mjekëve shqiptarë me tranjerët për të pasur arritje në sportin shqiptar, i cili është zbehur këto vitet e fundit në vendin tonë. Në ceremoninë përfundimtare z. Stavri Bello, Sekretar i Përgjithshëm i KOKSH dhe Drejtori i Seminarit Kombëtar Dr. Muhamet Ostrteni dorëzuan certifikata pjesmarrësve në këtë aktivitet të Mjeksisë Sportive.



“Pescara 2009” Mbledhje e Komitetit Ekzekutiv dhe Komisioneve të ICMG

10-14 Prill 2007– Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello i cili është njëkohësisht anëtar i Komisionit Teknik të ICMG, në datat 10-14 ka marrë pjesë në mbledhjet e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare zhvilluar në qytetin e Pescara në Itali. Qëllimi i këtij takimi ishte mbi:

Raporti vlerësues të punës së çdo komisioni për vitin 2006 dhe planifikimi për vitin 2007.

Ekspozita fotografike e veprimtarive të Federatave Sportive Shqiptare

16 Prill 2007- Z. Domi President i KOKSH ka zhvilluar një takim pune në zyrën e Agjencisë Kombëtare të Shërbimeve Sportive me pjesëmarrjen e të gjitha Federatave Sportive Shqiptare për një iniciativë të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar në realizimin e një ekspozite fotografike të veprimtarive të përbashkëta e cila do të shërbejë për të promovuar sportet Shqiptare gjatë aktiviteteve sportive.

KOKSH në Seminarin Rajonal të Komitetit Olimpik European “Mjedisi dhe Sporti për të Gjithë”



Organizuar nga Komiteti Olimpik Slloven / Ljubljana, 6-7 Prill 2007

Regional Seminar
“Environment &
Sport for All”
6-7 April 2007

Sa herë që ne marrim pjesë në aktivitete sportive, si pjesëmarrës apo spektatorë, ne gjithmonë kemi një impakt mbi mjedisin. Në të njëjtën kohë, gjëndja e mjedisit mund të ketë efekt të dëmshëm tek

ne ndërsa ne merremi me aktivitet fizik apo sport.

Nën këtë linjë në Ljubljana të Sllovenisë Komiteti Olimpik European zhvilloi në datat 6-7 Prill 2007 Seminarin Rajonal me vendet e Europës me temë “Mjedisi dhe Sporti për të Gjithë” në të cilin KOKSH u përfaqësua me z. Kliton Muca.

Në seminar u ndanë mendime të shumta se si ta mbrojmë mjedisin, si ta shfrytëzojmë atë në mënyrën më të mirë të mundshme, rëndësinë që ka ai në jetën e njerëzve në përgjithësi dhe aktivitetit fizik e sportit në vecanti, po ashtu edhe lidhja që kanë me njëra tjetrën.

Një theks i veçantë u vu në ndërveprimin e aktorëve të ndryshëm si psh. autoriteteve lokale, qeveritare, or-



ganizatave sportive dhe ato mjedisore në fushat për edukimin mbi mjedisin, përmirësimin e cilësisë së ajrit, trajtimit të ujit, pyllëzimi, etj. Gjithmonë e më shumë në këtë çështje po rritet roli i Komisionit të Sportistëve pranë Komiteteve Olimpikë në promovimin e vlerave në mbrojtje të mjedisit.

“Zhvillimi ekonomik nuk duhet të sakrifikojë mjedisin ekologjik”

KOMISIONET E KOKSH

Mbledhje e Komisionit të Sportistit

Me kërkesë të Kryetares së “Komisionit të Sportistit” të KOKSH znj. Klodiana Shala ditën e Hënë, më datë 23 Prill 2007, në ambjentet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar u zhvillua mbledhja e radhës së “Komisionit të Sportistit”. Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello, i cili asistoi në mbledhjen e komisionit, bëri sygjërimet e duhura për një rol më aktiv të këtij komisioni në lidhje me problemet si: - pjesëmarrja e sportistëve në vendimarrje, të drejtat dhe detyrat e sportistëve. Objekti i kësaj mbledhje ishte: Programi për vitin 2007 i Komisionit të Sportistit.

Mbledhje e Komisionit “Femra dhe Sporti”

Komisioni “Femra dhe Sporti” të KOKSH më datë 23 Prill 2007, në ambjentet e Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar ka zhvilluar mbledhjen e radhës për përgatitjen e Konferencës së 3-të Kombëtare “Femra dhe Sporti”.

Rendi i Ditës për diskutim në mbledhje ishin:

- Përgatitja e Konferencës së 3-të Kombëtare “Femra dhe Sporti”:
- Programi
- Diskutim rreth temave dhe lektorëve
- Ceremonia e dhënies së Trofeut “Femra dhe Sporti”
- kandidaturat, forma e ceremonisë, drejtuesi

“Luaj Gjelber”, eja me ne të Shtunën në Dajt! - *KOKSH Partner*

6-7 Prill 2007 – “Luaj Gjelber” Iniciativat rinore janë dhe do të jenë pjesë e fokusit të aktivitetit të Lëvizjes Olimpikë Shqiptare ashtu si në të kaluarën.

Në datën 6 Prill partnerët në iniciativën “Luaj Gjelber” u mbledhën në një takim pune për finalizimin dhe promovimin e aktivitetit të datës 7 Prill.

Në 7 Prill 2007 në stacionin e nisjes së Teleferikut Dajt, pas Konferencës për Shtyp ku ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello, startoi iniciativa “Luaj Gjelber” me aktivitetin ngjitje ‘Hiking’ në malin e Dajtit. Kjo iniciativë vjen nga Partneriteti i: Fondacionit MJAFT - Këshillit Britanik - KOKSH

- ECAT Tirana - EDEN Center. Ky aktivitet kishte si objektiv realizimin e disa aktiviteteve sportive në natyrë, përmes të cilave synon të promovojë parqet kombëtare, jo vetëm si pasuri kombëtare të vendit tonë, por edhe si hapësira të gjelbëra në shërbim të njerëzve.

Për të prezantuar parqet tona kombëtare dhe për mbrojtjen e tyre u organizua një ngjitje në këmbë në Malin e Dajtit për promovimin e parkut kombëtar të Dajtit si pasuri natyrore dhe si vend i cili mund të shërbejë për shumë aktivitete dhe përfshirje qytetare. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe Sportistët Bursistët Olimpikë “Pekin 2008” Erkan Qerimaj (Peshëngritje) dhe Ergys Mirukaj (Mundje) nga KOKSH, 10 të rinj nga organizata “GOAL! 2006” në Angli dhe 10 të rinj nga Organizata “Za Zemiata” (Për tokën) në Bullgari. Nisja u bë nga ish Kampi i Pionereve, në Dajt për në Qafë Qershi.



Mbledhje e Komisionit “Sporti për të Gjithë”

Më datë 4 Prill 2007 u zhvillua mbledhja e radhës e Komisioni i Sportit për të Gjithë. Në mbledhje Komisioni i SPGJ diskutoi mbi organizimin e tryezës së rrubullakët që pritet të realizohet në muajt vijues. Çështjet që u diskutuan ishin:

- Raport informativ mbi projektet e realizuara për vitin 2006.
- Përcaktimi i datës për organizimin e tryezës së rrubullakët
- Diskutim mbi projektet e paraqitura për vitin 2007



Statusi Tip i federatave Sportive, KOKSH takim me Presidentë dhe Sekretarë të Federatave



24 Prill 2007 – Presidenti i KOKSH z. Domi thërriti në ambjentet e KOKSH një takim pune me titullarë të Federatave Sportive Shqiptare. Objekti i këtij takimi ishte diskutim dhe rrahje mendimesh rreth “Statusit Tip të federatave sportive”. Në takim u evidentuan vërejtje dhe u dhanë sygjerrime në mënyrë që ky status tip të jetë sa më i pranueshëm nga grupi i interesit dhe të gjejë përshtatshmëri. Në përfundim të takimit u la që të hartohet një shkresë me sygjerrimet konkrete dhe ti dërgohet Ministrit të MTKRS.

KOR Dibër – Kupa “7 Marsi” Kampionati i Volejbollit ndërmjet mësuesve



Për katër ditë me radhë, palestra “Korabi” u gjallërua nga tifozeria e shkollarëve, ku ndoqën me shumë interes takimet e mësuesve të tyre. Mësuesit e Shkollave 9-të vjeçare dhe të Mesme ishin protagonistët kryesorë të aktivitetit ku respekti, entuziazmi dhe kënaqësia ndërthureshin me njëra tjetrën. Fitues u shpall ekipi i mësuesve të shkollës “Seid Najdeni”.

Këto aktivitete do të pasohen me veprimtari të tjera nga të cilat është edhe Java dhe Dita Olimpikë e Vrapimit.

Haki Duka – Kryetar i KOR Dibër

KOR Korçë dhe Shoqata e Skive ”Rrëshqitja dhe Natyra”

– “Ndjesi dhe Emocione në një ditë të bardhë Olimpikë”. Qytetarët e Korçës si asnjë vit tjetër nuk e kanë pritur borën me kaq padurim. Në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Rajonale, Komitetin Olimpik Rajonal Korçë, Qendrën

Kulturore të Fëmijëve, Shoqatën e Skive “Rrëshqitja dhe Natyra” morën iniciativën të organizonin në fshatin turistik të Dardhës, Kampionatin Lokal të Skive midis shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Garat u zhvilluan në pistën e re të hapur nga Shoqata e Skive “Rrëshqitja dhe Natyra” dhe përfshinin disiplina të ndryshme si slalom special, zbritje e lirë, etj. Bukuria e këtij aktiviteti ishin fëmijët e vegjël të ciklit të ulët të cilët me pasionin dhe ëndrrat e tyre për tu bërë nesër kampionë, mposhtën frikën duke rrëshqitur me mjete të ndryshme që përfshihen në didaktikën e skive, si slita dhe platforma të ndryshme plastike. Ndër fituesit e kësaj gare ishte edhe Marina Tasho e cila përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin Olimpik Rinor Dimëror zhvilluar në “Jaca 2007”, Spanjë.

Koço Dino - QKF Korçë

“Vrapojmë për të Drejtat Tona”



“Qendra Sportive Shqiptare” e cila është një shoqatë me seli pranë shkollës “Vincenc Prendushi” Durrës, dhe e përhapur në gjithë vendin, me qëllim edukimin nëpërmjet aktiviteteve sportive, ka organizuar në muajin Mars 2007 aktivitetin e quajtur: “Vrapojmë për të Drejtat Tona”. Aktiviteti u zhvillua në formën e një maratone nëpër rrugët e qytetit të Durrësit, me rastin e ditës së të drejtave të fëmijëve dhe u shoqërua me aktivitete të ndryshme artistike.

Majlinda Piliçi

AKTIVITETE TË FEDERATAVE SPORTIVE

FEDERATA SHQIPTARE HENDBOLLIT



Federata Shqiptare e Hendbollit në bashkëpunim me Federatën Europiane të Hendbollit zhvilloi në Tiranë në datat 14-15 Mars 2007 seminarin e dytë teoriko-praktik për promovimin dhe zhvillimin e hendbollit në Shqipëri. Në këtë seminar morrën pjesë rreth 40 persona, mësues të edukimit fizik të shkollave e trajnerë të skuadrave të hendbollit nga Tirana, Shkodra, Elbasani, Durrësi e Kukësi.

Seminari u drejtua nga eksperti i EHF Asc.Prof. Dr.Frantisek Taborsky. Seminari u përqëndrua më shumë në zhvillimin e lojës së hendbollit te fëmijet e moshave 10-16 vjec dhe mënyra e zhvillimit të sistemeve të lojës së skuadrës në mbrojtje dhe në sulm etj.

Në përfundim, Presidenti i F.SH.H. Z. Myrteza Myftari dhe eksperti çek i EHF shpërndanë certifikatat për pjesmarrësit në këtë seminar.

FEDERATA SHQIPTARE E PESHENGRITJES

Kampionati Kombëtar për të Rritur – Tiranë

Në kampionatin Kombëtar për të rritur në peshëngritje të zhvilluar më datë 15 Mars 2007 në Pallatin e Sportit “Asllan Rusi” Tiranë, morrën pjesë 54 konkures nga të cilët 47 sportistë dhe 7 sportiste. Fituesit e kampionatit sipas rezultate:

Sportistja më e mirë u shpall Fetie Kasaj dhe ekipi kampion u shpall Dinamo, ndërsa sportisti më i mirë i aktivitetit u shpall Endri Haxhihyseni dhe ekipi kampion u shpall Prefektura Elbasan.

Pesha	Emri	Shkëputje	Shtytje Totali	
<i>Femra:</i>				
53kg – Sh. Guhaçaj		70kg	90kg	160kg
58kg – B. Rusi		65	85	150
63kg – F. Kasaj		95	130	225
<i>Meshkuj:</i>				
56kg – S. Veizi		90	110	200
62kg – D. Godelli		100	120	220
69kg – B. Calja		127	153	280
77kg – E. Qerimaj		150	190	340
85kg – T. Çerepi		150	185	335
94kg – E. Haxhihyseni	170		196	366
105 – K. Toska		150	181	331
+105 – I. Bala		187	210	397

FEDERATA SHQIPTARE E ATLETIKES

Zhvillimi i atletikës - Takim me trainerët

28 Mars 2007 - Presidenti i FSHA z. Fatos Shehaj zhvilloi në Hotel Rogner Europa Park një takim të hapur me trajnerët e atletikës pranë klubeve shumësportëshe. Objekti i këtij takimi ishte : “Si mendohet zhvillimi i Atletikës Shqiptare në vendin tonë”. I ftuar në këtë takim ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Bello i cili u shpreh se KOKSH është përherë i hapur të mbështesë zhvillimin e sportit të Atletikës nëpërmjet projekteve që do ti paraqiten.



FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

Kampionati Botëror i Notit, Melburn

Në Melburn të Australisë u zhvillua Kampionati Botëror i Notit në datat 17 Mars-1Prill 2007. Në këtë aktivitet i cili ishte njëkohësisht edhe kualifikues për Lojërat Olimpike "Pekin 2008" mori pjesë edhe delegacioni Shqiptar i përbërë nga:

Sportistët – Rovena Marku, Anisa Curraj, Eros Qama, Marbi Hani, Malbor Oshafi

Trainerë: Genci Oshafi, Shpëtim Damini dhe Spiro Koça Përgjegjës ekipi.

FEDERATA SHQIPTARE E JUDO-S

Kampionati European për të rritur në Judo



Nga data 5-8 Prill 2007, në Beograd të Serbisë u zhvillua Kampionati European për të rritur në Judo. Në këtë veprimtari e cila ishte e një rëndësie të vecantë pasi ishte në të njëjtën kohë edhe kualifikuese për Lojërat Olimpike "Pekin 2008", mori pjesë edhe Delegacioni Shqiptar. Sekretari i Përgjithshëm i FSHJ z. Labo Çapo ka zhvilluar takime me Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Europiane z. Mr. Encic Galeatw Judos nga i cili ka marrë premtime për mbështetje. Sportistët Besford Dorezi dhe Ylli Ujka u paraqitën më mirë në këtë aktivitet dhe po përgatiten së bashku me ekipin për në Kupën e Botës që do zhvillohet në Romë dhe që është kualifikuese për "Pekin 2008".

Në këtë veprimtari e cila ishte e një rëndësie të vecantë pasi ishte në të njëjtën kohë edhe kualifikuese për Lojërat Olimpike "Pekin 2008", mori pjesë edhe Delegacioni Shqiptar. Sekretari i Përgjithshëm i FSHJ z. Labo Çapo ka zhvilluar takime me Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Europiane z. Mr. Encic Galeatw Judos nga i cili ka marrë premtime për mbështetje. Sportistët Besford Dorezi dhe Ylli Ujka u paraqitën më mirë në këtë aktivitet dhe po përgatiten së bashku me ekipin për në Kupën e Botës që do zhvillohet në Romë dhe që është kualifikuese për "Pekin 2008".

FEDERATA SHQIPTARE E ÇIKLIZMIT

15 Prill 2007 – Kupa "Nderimi i Figurave të Çiklizmit"



"Nje respekt i vecante per sakrificen qe i dhane ketij sporti, unë i jam mirenjohes te gjithe ketyre figurave"- thote presidenti i FSHC Z. Skender Anxhaku.

Ne kete aktivitet moren pjese figura te nderuara te sportit Shqiptar nga Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH) Z. Stavri Bello (sekretar i


pergjithshem), Vladimir Gjonaj (anetar i kryesisë ne KOKSH, anetar i kryesisë ne FSHC) Te ftuar nga Ministria Turizmit Kultures Rinise dhe Sporteve Z. Arjan Konomi (drejtor i pergjithshem i sporteve ne Ministrine e Turizmit Kultures Rinise dhe Sporteve), Zj. Bardha Shtrepi (inspektore ne MTKRS). Te gjithë keto figura pershendeten aktivitetin "Perkujtimore" para dhe gjate tij.

Ky aktivitet eshte ne vitin e pare te tij dhe qe nga ky vit aktiviteti do te futet ne kalendarin sportiv te Federates Shqiptare te Ciklizmit ne vitet pasardhese.

FEDERATA SHQIPTARE E BULING

Sezoni "Buling 2007"

20 Prill 2007 Federata Shqiptare e Buling, federata më e re sportive ka nisur aktivitetin e saj zyrtar me organizimin e Sezonit "Buling 2007". Në Kompleksin e Lojërave "Blur", në Lundër të Tiranës, është çelur aktiviteti i parë i kësaj federate. Në ceremoninë zyrtare të hapjes së aktivitetit mori pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello.



FEDERATA SHQIPTARE E ALPINIZMIT

Wall climbing



27 Prill 2007 - Federata Shqiptare e Alpinizmit ka inaguruar objektin më të ri të disiplinës së Ngjitjes në Mur (Wall Climbing). Në një nga palestrat e Klubit Shumësportësh Partizani, është ndërtuar me financim të MTKRS objekti sportiv i ngjitjes në mur. Në

ceremoni morën pjesë titullarët e institucionve: zv. Ministria e MTKRS znj. Suzana Turku, Sekretari i Përgjithshëm i KOKSH z. Stavri Bello, Drejtori i Sportit në MTKRS z. Arjan Konomi, Presidenti z. Jani Sizo dhe Sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Alpinizmit z. Ilirian Cule, shefi i Klubit z. Afrim Tole dhe anëtarë të tjerë të federatës. Gjatë ceremonisë u zhvilluan demonstrime nga grupe alpinistësh të ardhur për këtë qëllim.

THE WORLDWIDE OLYMPIC PARTNERS / PARTNERË M SHTRIRJE BOTËRORE

